



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kontrolli i Lartë i Shtetit



RAPORT MONITORIMI VITI 2023

Plani Strategjik 2023-2027



Përgatitur nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit
Profesional



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 64 Prot.

Tiranë, më 04/05/2024

VENDIM

Nr. 81, Datë 04/05/2024

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT PËR VITIN 2023, TË PLANIT
STRATEGJIK 2023-2027

Bazuar në Vendimin nr. 247, datë 29.12.2022 të Kryetarit të KLSH-së, “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit, 2023-2027”; Vendimin nr. 144, datë 01.08.2023, “Për miratimin e Planit të veprimit për implementimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së, 2023 – 2027”, si dhe të Rregullores së Brendshme të KLSH-së, neni 34, pika 1.11/b:

VENDOSA

1. Miratimin e dokumentit “Raporti i Monitorimit për vitin 2023, i Planit Strategjik 2023-2027”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjithë departamentet, drejtoritë, sektorët sipas fushave të përgjegjësisë përkatëse, për marrjen e masave brenda vitit 2024, me qëllim përmbushjen e plotë të objektivave, të cilat sipas këtij Raporti Monitorimi rezultuan “në proces realizimi” ose “të pa realizuara”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



PËRMBAJTJA

01

Hyrje

02

Rëndësia e monitorimit të objektivave

03

Qëllimi 1

Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike

04

Qëllimi 2

Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve

05

Qëllimi 3

Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese

06

Objektivat e perealizuara dhe në proces

07

Anekse

HYRJE

Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027, është dokumenti më i rëndësishëm strategjik i institucionit, në linjë me misionin e tij, i cili udhëheq Kontrollin e Lartë të Shtetit në aktivitetin e tij institucional duke u përshtatur dhe përgjigjur në kohë dhe me përgjegjshmëri dinamikave dhe zhvillimeve lokale dhe globale.

Strategjia, orientohet drejt rritjes më tej të cilësisë së auditimeve, duke iu përgjigjur në mënyrë të vazhdueshme zhvillimeve të standardeve dhe rregulloreve të auditimit sipas ISSAI-ve, duke përditësuar metodologjitë, si dhe duke rritur përdorimin e vizualizimeve për të përmirësuar efikasitetin e përcjelljes së punës audituese.

Kjo nënkupton optimizimin e aftësive profesionale dhe njohurive inovative mbi standardet ndërkombëtare të fushës, për të gjithë trupën audituese dhe personelin mbështetës nëpërmjet trajnimeve dhe punës së përbashkët, me qëllimin për të zhvilluar më tej kuptueshmërinë e njohurive audituese, që nxisin veprim dhe prodhojnë rezultat.

K Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucion i pavarur, kushtetues, i cili nëpërmjet ekspertizës dhe auditimeve cilësore, mbështet Kuvendin dhe informon publikun dhe palët e interesit në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në menaxhimin e parasë së taksapaguesve, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike.

Me qëllim përmbushjen e objektivave strategjike, është hartuar plani i veprimit për implementimin e strategjisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 144, datë 01.08.2023. Ky plan monitorohet në vijimësi dhe në mënyrë sistematike për vlerësimin e nivelit të arritjes së objektivave kundrejt parashikimit.

Ky raport monitorimi synon të identifikojë dhe vlerësojë statusin e zbatueshmërisë së objektivave strategjike sipas planit të veprimit, njësitë përgjegjëse për secilin objektiv dhe veprimet e ndërmara për arritjen e tyre, si dhe dhe afatin e përmbushjes së objektivit përkatës.



RËNDËSIA E MONITORIMIT TË QËLLIMEVE & OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

“ KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përmirësimin e shërbimeve publike, nëpërmjet auditimeve cilësore dhe luftës kundër korrupsionit, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni.



Në përmbushje të misionit dhe vizionit të tij, KLSH ka përcaktuar tre qëllime strategjike që udhëheqin punën e institucionit, realizimi i të cilëve është kritik dhe monitorohet periodikisht.

Qëllimi Strategjik 1


Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike.

Qëllimi Strategjik 2

Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.

Qëllimi Strategjik 3

Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.



Infografik: % e objektivave të realizuara

Gjatë vitit 2023, rezulton se janë realizuar 95% e objektivave të përcaktuara.

Monitorimi i vazhdueshëm i arritjes së qëllimeve dhe objektivave strategjike, është i rëndësishëm pasi na siguron:

- ✓ Përafrim me misionin dhe qëllimet
- ✓ Përmirësim të vazhdueshëm
- ✓ Përshtatshmëri ndaj dinamikave
- ✓ Shfrytëzim efektiv të burimeve

QËLLIMI 1



RRITJA DHE PËRMIRËSIMI I ROLIT TË KLSH SI MBËSHTETËS I KUVENDIT PËR LLOGARIDHËNIE EFEKTIVE DHE SHQYRTIM TË KUJDESSHËM E TË THELLUAR TË ENTEVE PËRDORUESE TË FONDEVE PUBLIKE

KLSH dhe Kuvendi si pjesë e trekëndëshit të llogaridhënies, kanë role reciprokisht mbështetëse për të siguruar një qeverisje efektive dhe janë partnerë kryesor në promovimin e qeverisjes së mirë. Kuvendi mund të kryejë funksionet e tij vitale të mbikëqyrjes së aktivitetit qeveritar në mënyrë efektive dhe eficiente, kur ai përdor dhe mbështetet mbi punën audituese të KLSH-së. KLSH mund të jetë shumë më efektiv, nëse Kuvendi dhe komisionet e tij, sigurojnë forume për paraqitjen dhe diskutimin e rezultateve të rëndësishme të auditimeve, duke përbërë aleatin kyç në nxitjen e Ekzekutivit dhe në inkurajimin e institucioneve të tjera të pavarura, për të ndërmarrë veprimet e duhura korrigjuese të propozuara nga KLSH.

KLSH, nëpërmjet punës audituese synon të sigurojë një rritje të rolit të tij si institucion suprem auditimi në mbrojtje të financave publike në vendin tonë, duke përmirësuar performancën e vet institucionale audituese në përfitim të taksapaguesve dhe në mbështetje të Kuvendit për një shqyrtim të thelluar të punës së ekzekutivit.

Ky qëllim, përmbushet nëpërmjet tre objektivave të mëposhtme:

1.1 Kryerja e planifikimit strategjik bazuar në analizë të përditësuar risku me qëllim mbulimin efektiv me auditim dhe kryerjen e auditimeve cilësore

1.2 Implementimi i plotë i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira gjatë të gjitha fazave të auditimit

1.3 Komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm i KLSH-së me Kuvendin

1.1 Kryerja e planifikimit strategjik bazuar në analizë të përditësuar risku me qëllim mbulimin efektiv me auditim dhe kryerjen e auditimeve cilësore



1

Metodologjia e Planifikimit Vjetor të Auditimeve

Me qëllim planifikimin dhe përzgjedhjen e temave të auditimit mbi bazë risku, për të siguruar mbulueshmëri me auditime të fushave dhe subjekteve me risk të lartë, Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional, gjatë vitit 2023 ka hartuar "Metodologjinë e Planifikimit Vjetor të Auditimeve" miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 166, datë 26.09.2023. Ky dokument, unifikon procesin e planifikimit të auditimeve duke përcaktuar indikatorët më të rëndësishëm të cilët duhet të mbahen në konsideratë dhe të vlerësohen për përzgjedhjen e temave.

2

Përzgjedhja e auditimeve mbi bazë risku

Në kuadër të hartimit të planit vjetor të auditimeve për vitin 2024, të gjitha departamentet e auditimit kanë zhvilluar workshope, ku audituesit kanë propozuar tema auditimi, dhe më pas vlerësimi e përzgjedhja e tyre është bërë duke përdorur metodologjinë e mësipërme. Departamenti i Auditimit të Performancës, vlerësimin dhe përzgjedhjen e temave të auditimit e ka kryer bazuar gjithashtu në Udhëzuesin e Fushave me Risk.



3

Monitorimi i planit të auditimeve

Plani i auditimeve, gjatë gjithë vitit 2023, është monitoruar vazhdimisht, me qëllim reflektimin e dinamikave makroekonomike dhe prioriteteve, sipas nevojës. Plani vjetor i auditimeve për vitin 2023, është miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së 234, datë 16.12.2022, dhe ka parashikuar realizimin e 154 auditimeve, si dhe një listë me 16 auditime potencialisht të mundshme gjatë vitit 2023, në varësi të kohës dhe burimeve në dispozicion. Me qëllim reflektimin e dinamikave makroekonomike dhe prioriteteve, KLSH e ka tejkaluar planin vjetor 2023, me 6 auditime (duke realizuar në total 160* auditime të realizuara).



4

Mbulimi me auditime i fushave të OZHQ

Në përmbushje të qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm sipas Axhendës 2030, nëpërmjet punës audituese, në përputhje edhe me prioritetet strategjike të INTOSAI-t, gjatë vitit 2023 Departamenti i Performancës ka kryer tre auditime që mbulojnë tre nga fushat e OZHQ-ve, konkretisht:

- Fuqizimi ekonomik i gruas në vendin tonë;
- Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës) nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Ndryshimet klimatike, i cili është duke u zhvilluar me mbështetjen e IDI.



*160 auditime kanë rezultuar në 185 opinione financiare & përputhshmërie, 8 konkluzione në auditimet IT, 17 mesazhe në auditimet e performancës dhe 14 konkluzione në auditimet e përputhshmërisë për çështje të veçanta.

1.2

Implementimi i plotë i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira gjatë të gjitha fazave të auditimit

1

Adoptimi dhe përditësimi i udhëzuesve/manualeve

Me qëllim sigurimin e vazhdimësisë, profesionalizmit, dhe cilësisë së zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, janë adoptuar dhe përditësuar vazhdimisht udhëzuesit dhe manualët duke iu përgjigjur në kohë ndryshimeve. Nisur nga praktikat e mira të INTOSAI-t, iniciativa e Komisionit Evropian "Mbi të shkruarin qartë për Evropën", si dhe nga nevoja për shkrimin e raporteve të auditimit me një gjuhë të thjeshtë e të qartë, Departamenti i Metodologjisë, gjatë vitit 2023 ka hartuar "Udhëzuesin mbi shkrimin e raporteve të auditimit" Gjithashtu, nisur nga rëndësia e planifikimit mbi bazë risku, është përditësuar dhe rikonceptuar "Metodologjinë e Planifikimit Vjetor të Auditimeve". Departamenti i Metodologjisë ka zhvilluar trajnime në mënyrë që gjithë audituesit të njihen me këto udhëzues.



2

Zhvillimi i moduleve IT

Me qëllim zhvillimin e moduleve IT për përdorimin e elementeve të auditimeve të IT-së edhe në auditimet e përputhshmërisë, financiare dhe të performancës, përgjatë vitit 2023, Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit ka vijuar bashkëpunimin me ekspertët e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë (OANG) në drejtim të përmirësimit të cilësisë së auditimeve me anë të zhvillimit të workshopeve online dhe onsite si dhe webinarëve. Gjithashtu, është marrë pjesë në workshopin e IT workgroup EuroSAI në tetor 2023 dhe webinarin ARABOSAI dhjetor 2023.



3

Orientimi drejt auditimeve të sistemit

Duke ndjekur praktikat e mira, duke marrë në konsideratë ndryshimet makroekonomike të diktuar nga evoluimi i shpejtë i teknologjisë, bazuar edhe në rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, gjatë vitit 2023, është synuar orientimi drejt auditimeve të sistemeve me qëllim parandalimin e fenomeneve që kanë impakt negativ në financat publike. Gjatë vitit 2023, janë kryer tre auditime mbi bazë sistemi, konkretisht:

- 01** Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme, zhvilluar në MFE dhe MIE.
- 02** Ecuria e detyrimeve shtetërore për vendime të formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi, zhvilluar në Avokaturën e Shtetit dhe MFE.
- 03** Auditimi i përputhshmërisë në licencimin dhe monitorimin e subjekteve me veprimtari në fushën minerare për periudhën 2018-2022.

4

Modernizimi logjistik

Në kuadër të modernizimit logjistik përmes implementimit të teknologjive inovative, gjatë vitit 2023 u zgjerua me staf Drejtoria e Shërbimit IT, e cila është njohur me proceset e brendshme të KLSH-së, ku si hap i parë ka identifikuar nevojat për dixhitalizim.



5

Bashkëpunimi me SAI-et homologe, me EUROSAT/ INTOSAT-n dhe institucione ndërkombëtare

Gjatë vitit 2023, KLSH ka vijuar bashkëpunimin me SAI homologe EUROSAT /INTOSAT-n dhe institucione të tjera ndërkombëtare ku përmendim:

EUROSAT

- Simpoziumi i EUROSAT-t "Çështjet Emergjente";
- workshop DEA/SG2 i EUROSAT-t;
- Takimi prezantues i projekt grupit të EUROSAT-t "Përfitimet dhe Metodologjitë e Auditimit në kohë reale"
- Takimi i Komitetit të Kontaktit dhe Koordinatoreve të SAI-ve të Rrjetit të Vendeve Kandidate dhe Kandidate të mundshme për në BE;
- Summer school of investigation;
- Takimi vjetor WGEA/ Seminari ndërkombëtar "Green SAI's";
- "Forumi të punojmë së bashku" EUROSAT - ECIIA - Marrëdhëniet me grupet jo të interesit të SAI-ve;
- Takimi XVI EUROSAT /ITëG;
- Seminari mbi Auditimet e Përputhshmërisë, SIGMA Network of SAI's;
- SG2 Metodologjia në Auditim workshop 5 DEA/SG2.

INTOSAT / IDI

- workshop rajonal organizuar nga UNODC "Rritja e bashkëpunimit mes SAI-ve dhe organeve anti-korrupsion"
- IDI Masterklas mbi Lidërshtipin
- Kursi i IDI-t për SPMR (raportimi dhe zbatimi);
- Akademia mbi Qeverisjen e SAI-t organizuar nga IDI;
- Takimi "Përcaktimi i një mekanizmi proaktiv mbrojtjeje për pavarësinë e SAI-ve"

Vizita zyrtare

- Vizita zyrtare në SAI-n e Emirateve të Bashkuara Arabe;
- Vizita zyrtare në Gjykatën e Llogarive të Italisë dhe Guardia di Finanza – ANAC;
- Vizita zyrtare në Gjykatën e Llogarive të Turqisë.
- Pjesëmarrja e nivelit të lartë të KLSH-së në 20-vjetorin e krijimit të ZKA të Kosovës dhe 19 vjetorin e krijimit të SAI-t të Malit të Zi.
- Takimi vjetor i Komitetit të Kontaktit me pjesëmarrjen e Presidentëve të SAI-ve të vendeve anëtare të BE-së, ECA-s (Gjykata Europiane e Llogarive) si dhe përfaqësues të lartë të Komisionit Europian.

Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet homologe: janë zhvilluar disa auditime paralele dhe të përbashkëta; ka vijuar bashkëpunimi me SAI-n e Suedisë; si dhe janë zhvilluar takime, workshope e konferenca me partnerë të rëndësishëm.

Auditime paralele/ të përbashkëta

- “Fuqizimi ekonomik i gruas në vendin tonë” në kuadër të projektit “Financimi transformues për barazinë gjinore drejt një qeverisjeje më transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor”;
- Auditimi paralel me temë “Sistemet e TI-së në Ujësjetllës -Kanalizime Tiranë sh.a”, në bashkëpunim me ZKA e Kosovës;
- Auditimi i performancës në kuadër të programit PA për audituesit e rinjë organizuar nga SAI i Suedisë për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë me temë “Shërbimi i Policisë në Përgjigje të Qytetarëve”;
- Auditimi i përbashkët global “Mbi veprimet e adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike” IDI-INTOSAI /WGEA.

Bashkëpunimi me SAI, Suedi

- Bashkëpunimi me SAI-n e Suedisë:
- workshopi rajonal për drejtuesit e SAI-ve organizuar në Strugë në 3-6 shtator 2023;
- Konferenca/seminari “Marrëdhënia efektive ndërmjet SAI-ve dhe palëve të interesit SIGMA/SNAO organizuar në Sarajevë;
- workshopi Block III - Programi Rajonal i Trajnimit për AP/SAI i Suedisë.

Takime të tjera

- Takimi vjetori i CNAB - Bordi i Audituesve të NATO-s;
- Vizita studimore pranë zyrave të ANAC nën koordinimin e OSBE;
- “Fellowship Program” i Zyrës së Llogaridhënies Qeveritare të SHBA-së (U.S.GAO);
- Internshipi i ECA-s (Gjykata Evropiane e Llogarive).
- Auditues të KLSH-së kanë marrë pjesë në rreth 20 takime të organizuara online, të cilat kanë trajtuar tema të ndryshme si: Lufta kundër korrupsionit, ndryshimet klimatike, politikat ndërkombëtare në luftën ndaj pastrimit të parave, identifikimi elektronik dhe sfidat e tij,
- Metodologjia e auditimit të bashkive, etj.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka zhvilluar përgjatë vitit 2023, angazhimin e gjithanshëm me partnerët e jashtëm dhe të brendshëm, në ndjekje të praktikave më të mira, me qëllim rritjen e impaktit të punës audituese dhe optimizimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale, për t'iu përshtatur sa më mirë kontekstit në të cilin operon.

Viti 2023 shënon anëtarësimin e KLSH-së në Task Forcën e INTOSAI-t për “Pjesëmarrjen qytetare dhe angazhimin e shoqërisë civile” të kryesuar nga SAI i Perusë. Gjithashtu në kuadër të INTOSAI-t stafi i KLSH-së është angazhuar në një sërë aktiviteteve.

Një ndër partnerët kryesorë të KLSH-së vijon të mbetet Iniciativa për Zhvillim (IDI) e INTOSAI-t (IDI). Gjatë vitit 2023, IDI ka vijuar të asistojë në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe njerëzore të audituesve në KLSH-së.

Viti 2023 shënon anëtarësimin e KLSH-së në Projekt Grupin e EUROSAT-t për “Përfitimet dhe Metodologjitë e auditimit në kohë reale” në kuadër të Qëllimit Strategjik 1 të EUROSAT-t, “Ngritja e kapaciteteve”, takimi prezantues i të cilit u zhvillua në Gjykatën e Llogarive të Italisë në datën 11 maj 2023.

KLSH ka vijuar aktivitetet në kuadër të grupeve të punëve dhe Task Force për: Auditimet e Mjedisit, Teknologjinë e Informacionit, Auditimet e Bashkive, etj.

Gjithashtu në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të ndërsjellë të nënshkruar me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Norvegjisë janë zhvilluar një sërë aktiviteteve të parashikuara në planin 2-vjeçar të miratuar me homologët në fushën e IT, performancës, mjedisit, në fushën e auditimit të industrive nxjerrëse dokumentimin e rezultateve nëpërmjet teknikave të auditimit, etj,

Me qëllim shkëmbimin e eksperiencave më të mira dhe praktikave audituese, KLSH përgjatë vitit 2023 ka vijuar angazhimin në auditimet ku janë përmbyllur:

- auditimi paralel me temë “Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e Bashkive për të siguruar shërbime cilësore për qytetarët gjatë pandemisë “. Në muajin korrik 2023 u publikua Raporti i përbashkët përfundimtar i auditimit ku KLSH dhe në muajin shtator 2023 u zhvillua në Shkup takimi përmbyllës i këtij auditimi ku KLSH mori pjesë së bashku me SAI-t e Polonisë, Rumanisë, Sllovakisë, Malit të Zi dhe Turqisë;
- auditimi paralel me temë “Sistemet e TI-së në Ujësjetës – Kanalizime Tiranë SH.A”. Ky auditim u zhvillua në bashkëpunim me ZKA-në e Kosovës dhe raporti përfundimtar i përbashkët u prezantua në takimin përmbyllës të zhvilluar në Tiranë në muajin dhjetor 2023.

Në muajin maj 2023, KLSH u bë pjesë gjithashtu e iniciativës së IDI-t në auditimin global të përbashkët organizuar në bashkëpunim edhe me Grupin e Punës së INTOSAI-t për auditimet e mjedisit, INTOSAI/WGEA për “Përshtatjen e aksionit të ndërmarrë në kuadër të ndryshimeve klimaterike”.

Përgjatë vitit 2023, u zhvilluan edhe një sërë aktivitete të tjera me prezencë fizike dhe në formatin online ku përfaqësues të KLSH-së kanë marrë pjesë respektivisht:

- 2 Simpoziumet e EUROSAT-t për "Çështjet Emergjente" duke trajtuar tematikat e auditimit në kohën e transformimeve digjitale zhvilluar në Londër në datat 30-31 janar 2023 dhe auditimet për rimëkëmbjen e shërbimeve publike zhvilluar në Lisbonë në datat 30-31 tetor 2023;
- workshop-e DEA/SG2 (data envelopment analysis) të EUROSAT-t; në kuadër të Qëllimit Strategjik 2 “Standardet Profesionale” të zhvilluara në Madrid në datat 9-10 shkurt 2023 dhe Varshavë në datat 10-11 dhjetor 2023, si dhe mbi metodologjinë në auditime zhvilluar në Varshavë në datat 15-16 nëntor 2023;
- takimi mbi “Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet SAI-ve dhe OJQ në luftën kundër korrupsionit” organizuar online nga Transparency International dhe IDI zhvilluar më datë 7 mars 2023;
- “Summer school of investigation” organizuar nga Gjykata Hollandeze e Auditimit në bashkëpunim me UKNAO dhe EUROSAT me në fokus konceptin e auditimeve investigative dhe eksplorimin e mënyrave të reja të me qëllim rritjen e impaktit dhe eficiencës zhvilluar në Hagë në datat 3-5 korrik 2023;
- forumi “Të punojmë së bashku” organizuar nga EUROSAT - ECIIA mbi marrëdhëniet auditues i jashtëm dhe auditues i brendshëm me në fokus të kuptuarin e punës së ndërsjellë dhe promovimin e roleve të përbashkëta zhvilluar në Bruksel në datën 6 tetor 2023;
- takimi i Bordit të audituesve të NATO-s zhvilluar më datë 7 qershor 2023;
- workshopi rajonal organizuar nga UNODC “Rritja e bashkëpunimit mes SAI-ve dhe organeve anti-korrupsion” zhvilluar në Vjenë në datat 31 maj – 2 qershor 2023;
- takimi mbi “Bashkëpunimin ndërmjet audituesve të brendshëm dhe të jashtëm” organizuar online nga SAI i Letonisë/EUROSAT/ECIIA zhvilluar më datë 16 mars 2023;
- forumi Anti-korrupsion dhe Siguria Kombëtare organizuar online nga Qendra për Studimin e Demokracisë, Ministria e Drejtësisë e Bullgarisë dhe Instituti Bazel zhvilluar më datë 21 mars 2023;
- masterklasi për metodologjinë e auditimit të bashkive organizuar online nga EUROSAT/TFMA zhvilluar më datë 30 mars 2023;

- webinari post COVID-19 organizuar nga UKNAO zhvilluar më datë 24 prill 2024;
- webinari "SAI PMF in the new era" organizuar nga IDI i zhvilluar më datë 27 prill 2023;
- fellowshipin e Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, GAO për periudhën 3 maj – 28 korrik 2023 me 1 auditues.
- internshipin e Gjykatës Evropiane të Llogarive ECA për periudhën 1 mars - 31 korrik 2023 me dy auditues, etj.

Edhe gjatë vitit 2023, KLSH ka vijuar komunikimet dhe takimet me ekspertët e SIGMA-s dhe grupit të punës të ngritur në KLSH për hartimin e Manualit praktik mbi Auditimin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit.

Në kuadër të bashkëpunimit të filluar tashmë që në vitin 2021, OSBE në partneritet me ANAC kanë përmbyllur në 5-6 qershor 2023 modulën VI dhe të fundit të trajnimit të audituesve të KLSH-së mbi vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve të korrupsionit në fushën e prokurimit publik.

Në kuadër të Projektit “Forcimi i mbikëqyrjes së kontratave të koncesionit dhe partneritetit publik privat në Shqipëri” i financuar nga Sekretariati i Çështjeve Ekonomike të Zvicrës (SECO), u finalizua gjatë vitit 2023 auditimi pilot “Kontrata e koncesionit për ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontenierëve dhe automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifën e skanimit” dhe ka përfunduar në terren auditimi i dytë pilot “Për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve”.

Ky projekt përfshin një sërë objektivash të pritshme, ku përmendim: (I) kryerjen e 3 auditimeve pilot në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve; (II) zhvillimin e kapaciteteve audituese në këtë fushë nëpërmjet trajnimeve nga ekspertët e jashtëm; si dhe (III) hartimin e një Manuali për auditimin e koncesioneve dhe PPP-ve. Së bashku me finalizimin e auditimit pilot të parë, të kryer tashmë, është konceptuar, hartuar dhe aplikuar Metodologjia e Auditimit të Koncesionave dhe PPP-ve (e cila pritet të kthehet në një Manual të mirëfilltë që do të udhëheq punën audituese).

Në zbatim të memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet KLSH-së dhe UN Women Albania, me qëllim ofrimin e asistencës në drejtim të barazisë gjinore dhe monitorimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor u zhvillua më datë 8 maj 2023, takimi me përfaqësuesit e UN Women në Shqipëri, z. Michele Ribotta dhe përgjegjësen e Zyrës së Bashkëpunimit Suedez për Zhvillim në Shqipëri, znj. Petra Burcher, me rastin e prezantimit të auditimit të performancës me temë “Fuqizimi ekonomik i gruas në Shqipëri” 2016-2021, i kryer në kuadër të projektit “Financimi transformues për barazinë gjinore drejt një qeverisje më transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor” i financuar nga qeveria e Suedisë (SIDA).

1.3 Komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm i KLSH-së me Kuvendin

1 Dëgjesat e zhvilluara dhe raportet e auditimit të përcjella në Kuvend


KLSH ka vijuar të intensifikojë komunikimin dhe bashkëpunimin me Kuvendin, duke përcjellë vazhdimisht raporte auditimi në Kuvend edhe gjatë vitit 2023. Gjithashtu, Kuvendi është informuar periodikisht për rezultatet e punës audituese edhe nëpërmjet përcjelljes së buletineve statistikore periodike, raporteve periodike të zbatimit të rekomandimeve, raportit mbi zbatimin e buxhetit të shtetit dhe raportit vjetor mbi performancën e KLSH-së. Gjithashtu, gjatë vitit 2023 në Komisionin e Ekonomisë është raportuar për "Raportin e Performancës" dhe "Raportin e Buxhetit" (online).



2 Raportet e zbatimit të rekomandimeve

KLSH i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministrinë të Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin, dy raporte përmbledhëse: "Raportin përmbledhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të përfunduara për periudhën 01.07.2021-31.12.2021" dhe "Raportin përmbledhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të përfunduara për periudhën 01.01.2021-31.12.2021"





3 Plotësimi periodik i Platformës Ndërinstitucionale Online të Kuvendit mbi zbatimin e rekomandimeve

Një mjet efektiv për informimin në kohë mbi zbatueshmërinë e rekomandimeve të KLSH-së, është Platforma Ndërinstitucionale on-line e Kuvendit të Shqipërisë, e cila ka vijuar plotësimin dhe përditësimin periodik gjatë vitit 2023 nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional.



4 Riorganizimi i statistikave në funksion edhe të zbatimit të rekomandimeve

Gjatë vitit 2023, KLSH rikonceptoi tërësisht formatin e statistikave të auditimeve duke përdorur formate më të avancuara të Excel-it, të cilat ofrojnë mundësinë e përpunimit të të dhënave sipas kërkesës. Nëpërmjet formatit të ri, Sektori i Statistikës, mund të përmbledhë, rendisë, riorganizojë, grupojë, numërojë, përlllogarisë vlera totale ose mesatare të të dhënave të ruajtura në një tabelë.

Gjithashtu, u rikonceptua në tërësi formati statistikor mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, duke u sjellë në formë të tillë që të mund të shërbejë edhe si regjistër rekomandimesh, për t'u ndjekur në çdo kohë. Në këtë regjistër, ndryshe nga vitet e tjera, janë hedhur të dhëna edhe për ato rekomandime, zbatimi i të cilave është parë si një drejtim i veçantë (pikë më vete) i programit të auditimit (psh në rastet e subjekteve të cilat auditohen çdo vit), duke mundësuar raportimin mbi një numër më të lartë auditimesh. Po njëjllë si statistikave të auditimeve, edhe ky format ofron mundësinë e përdorimit të përlllogaritjeve të avancuara mbi të dhënat që plotësohen.




Tabela 3: Masat organizative dhe Propozime për përmirësimet ligjore

Nr	Llojet e auditimit	Nr auditimesh	Masa organizative	Përmirësimet ligjore	Total
1	Auditimet financiar dhe përputhshmëri	31	565	3	598
	Institucionet e vetëqeverijës vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	11	115		115
	Institucionet të qeverisë qendrore dhe të varfësisë	5	61	2	63
	Institucionet e administrimit të aseteve dhe mbrojtjes së mjedistit	4	99	1	100
	Shoqëritë publike dhe projektet me financim të huaj	11	290		290
2	Auditimet të kombinuara	28	722	2	724
	Institucione të pavarura	1	8		8
	Institucione të qeverisë qendrore dhe të varfësisë	5	140	2	142
	Institucionet e administrimit të aseteve dhe mbrojtjes së mjedistit	1			35
	Institucionet e vetëqeverijës vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	21	539		539
3	Auditimet IT	4	56		56
	Institucionet në të cilat janë kryer auditimet IT	4			56
4	Auditimet Performance	8	141	6	147
	Institucionet në të cilat janë kryer auditimet e performancës	8	141	6	147

QËLLIMI 2



RRITJA E IMPAKTIT TË PUNËS AUDITUESE NË QEVERISJEN E MIRË NËPËRMJET PËRMIRËSIMIT TË NIVELIT TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

KLSH, synon të rrisë impaktin e punës audituese dhe të kontribuojë në qeverisjen e mirë, nxitjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe transparencës së përdorimit të fondeve publike, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve praktike, të qarta dhe të orientuara drejt veprimeve konkrete, për përmirësimin e situatës së konstatuar dhe forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Monitorimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve nga entet publike të audituara, në bashkëpunim edhe me Kuvendin, me qëllim nxitjen e institucioneve publike për zbatimin e tyre, është treguesi kryesor për matjen e impaktit të punës audituese.

Ky qëllim, përmbushet nëpërmjet pesë objektivave të mëposhtme:

2.1

Promovimi i vazhdueshëm i rolit të KLSH-së dhe punës audituese, si garantues i mirëpërdorimit të fondeve publike, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit

2.2

Thellimi dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese

2.3

Forcimi i pavarësisë dhe mandatit të KLSH-së

2.4

Hartimi i raporteve të auditimit, të kuptueshme, të qarta dhe relevante për lexuesin

2.5

Përdorimi i teknikave të të shkruarit profesional që përcjell informacion, gjetje dhe rekomandime në mënyrë të qartë, koncize dhe efektive

2.1 Promovimi i vazhdueshëm i rolit të KLSH-së dhe punës audituese, si garantues i mirëpërdorimit të fondeve publike, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit

KLSH ka paraqitur dhe komunikuar punën audituese duke përdorur kanalet më efektive të komunikimit për të mbërritur deri tek përdoruesi më i fundit, qytetari. Në funksion të misionit që ka, KLSH synon t'u shërbejë qytetarëve dhe taksapaguesve, duke u ofruar mundësinë dhe aksesin e plotë në informacion për të kontribuar në realizimin e qëllimit të përbashkët, që është mirëqeverisja.



1

Publikimi dhe promovimi i raporteve të auditimit nëpërmjet broshurave

Kështu, gjatë vitit 2023, KLSH ka publikuar në faqen web raportet e auditimit me qëllim promovimin e punës audituese dhe informimin e vazhdueshëm të palëve të interesit. Gjithashtu, për auditimet me ndjeshmëri të lartë, ka promovuar rezultatet e auditimit nëpërmjet përgatitjes së broshurave, dhe shpërndarjen e tyre tek të gjithë të ftuarit, gjatë aktiviteteve të analizave vjetore të departamenteve të auditimit. Gjatë vitit 2023 janë përgatitur:

- 01 Broshurë informuese mbi rolin dhe veprimtarinë e KLSH-së, në gjuhën shqipe dhe angleze.
- 02 Broshura informuese mbi aktivitetin e departamenteve të auditimit (6 broshura, 1 për çdo departament auditimi).
- 03 Broshurë informuese mbi auditimin e performances “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”.
- 04 Broshurë informuese mbi auditimin e performances “Fuqizimi ekonomik i gruas në vendin tonë”, në bashkëpunim me zyrën UN women në Shqipëri.
- 05 Broshurë informuese mbi aktivitetin e KLSH, në drejtim të përmirësimit të kuadrit metodologjik të punës audituese.



2

Promovimi i raporteve të auditimit nëpërmjet organizimit të aktiviteteve

Në kuadër të promovimit të raporteve të auditimit, kryesisht performance, gjatë vitit 2023 KLSH ka organizuar aktivitete në të cilat kanë marrë pjesë dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Aktivitetet janë zhvilluar për auditimet me temë:

- “Fuqizimi ekonomik i gruas në Shqipëri”;
- “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”.



3

Artikuj dhe kronika në median audio-vizive mbi veprimtarinë e KLSH


Gjatë vitit 2023, në shtypin e shkruar janë publikuar 480 artikuj nga 300 që ishin në vitin 2022 (ose 180 më shumë) si dhe 1756 artikuj e kronika në median audio-vizive dhe online nga 1500 artikuj dhe kronika në vitin 2022 (ose 256 më shumë), të cilat i referohen veprimtarisë audituese të institucionit.



4

Pasurimi i faqes së web-it

Me qëllim që faqja e web-it të jetë lehtësisht e përdorshme edhe nga partnerët ndërkombëtarë, ka filluar pasurimi i saj me informacione dhe materiale edhe në gjuhën angleze. Gjithashtu, Departamenti i Metodologjisë ka rikonceptuar formatin e buletinit statistikor, duke e pasuruar me vizualizime, cili përmban infografikë lehtësisht të kuptueshëm dhe statistika që shndërrohen në lajm.



5

Administrimi i ankesave dhe kërkesave

Gjatë vitit 2023 KLSH ka administruar 368 letra, ankesa/ kërkesa për informacion nga individë dhe subjekte të ndryshme. Si një njësi dedikuar vetëm kërkesave për informacion, Koordinatorin për të drejtën e informimit ka trajtuar 28 kërkesa për informacion të cilat janë përcjellë tek kërkuuesit brenda afateve ligjore të përcaktuara nga ligji.

2.2 Thellimi dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese

Bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese i shton vlerë punës audituese, duke raportuar rastet korruptive të konstatuara nga KLSH. Për këtë qëllim, KLSH ka synuar rritjen e bashkëpunimit për shkëmbimin e informacionit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, me organet e linjës së parë në luftën kundër korrupsionit.

Gjatë vitit 2023 përfaqësues të institucionit kanë marrë pjesë në aktivitete dhe tryeza të rrumbullakëta të organizuara nga OJF me qëllim luftën kundër korrupsionit.

- 01 Më 11 korrik 2023, KLSH merr pjesë në tryezën e diskutimit me temë: “Fuqizimi i rolit mbikëqyrës të legjislacionit në vlerësimin e hapësirave për korrupsion”, organizuar nga Fondacioni eestminster për Demokraci në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Kërkime Ekonomike.
- 02 Më 15 shtator 2023, KLSH merr pjesë në prezantimin e raportit “Fuqizimi i rolit të Kuvendit të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit”, organizuar nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI).
- 03 Më 28 shtator 2023, KLSH merr pjesë në takimin “Nevoja për përmirësim në Legjislacionin e Prokurimit Publik (Kapitulli 5: Integrimi)”, organizuar nga Instituti Shqiptar i Shkencës/ Open Data Albania.
- 04 Më 4 dhjetor 2023, KLSH merr pjesë në workshop-in “Fuqizimi i rolit të shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit”.
- 05 Më 10-12 Dhjetor 2023, KLSH merr pjesë në takimin e organizuar nga ANAC në Romë.
- 06 Më 28 shtator 2023, KLSH merr pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Albanian Institute of Science mbi nevojën për përmirësimin e legjislacionit të prokurimeve publike për të minimizuar risqet e korrupsionit.
- 07 Më 13 dhjetor 2023, KLSH merr pjesë në forumin "Roli Parlamentar në procesin Demokratik në Shqipëri", organizuar nga WFD Albania

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet ligj-zbatuese, ka adresuar 67 materiale për auditime të ndryshme në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në kuadër të veprimeve hetimore që po kryhen nga ky i fundit, si dhe ka kallëzuar penalisht 10 zyrtarë të administratës shtetërore për veprën penale shpërdorim i detyrës të parashikuar nga neni 248 i Kodit penal, si dhe shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal të kryera në bashkëpunim më shumë se njëherë.

Gjithashtu, 24 materiale auditimi I janë adresuar Prokurorive pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në kuadër të nisjes apo vijimit të veprimeve hetimore që kryhen nga ana e këtij organi në kuadër të procedimeve penale.

2.3 Forcimi i pavarësisë dhe mandatit të KLSH-së

Pavarësia dhe mandati i KLSH-së janë sanksionuar në Kushtetutë dhe në Ligjin Organik, duke u konsideruar si kusht i domosdoshëm për përmbushjen e misionit dhe arritjen e qëllimeve strategjike.

Për të forcuar pavarësinë dhe mandatin kushtetues, KLSH parashikon të përfundojë rishikimin e ligjit organik, me qëllim reflektimin e ndryshimeve më të fundit të rrethanave dhe mjedisit që ka impakt në punën audituese, në përputhje kjo edhe me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Gjatë vitit 2023 është mbajtur një takim me grupin e punës për tu shqyrtuar punën e realizuar deri tani nga ky grup. Në vijim, me urdhër nr. 97 datë 14.12.2023 është rishikuar grupi i punës për përgatitjen e ndryshimeve të ligjit nr.154/2014, në të cilin kërkohet marrja e asistencës së ekspertëve vendas dhe të huaj dhe sigurimin e një konsultimi interaktiv me këta të fundit për realizimin e draftit të kërkuar.

<p style="text-align: center;">LIGJ Nr. 154/2014</p> <p style="text-align: center;">PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KONTROLLIT TË LARTË TË SHQIPTIT</p> <p>Në mbështetje të neneve 81, 83, pika 1, dhe 162 deri në 165 të Kushtetutës, me propozimin e deputetit Erion Braçe,</p> <p style="text-align: center;">KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË</p> <p style="text-align: center;">VENDOSI:</p> <p style="text-align: center;">KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Objekti</p> <p>Ky ligj përcakton rregullat që kanë të bëjnë me organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Kontrollit të Lartë të Shtetit në Republikën e Shqipërisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 2 Qëllimi</p> <p>Kontrolli i Lartë i Shtetit, nëpërmjet auditimeve, synon përdorimin me efikasitet të fondave publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve të informimit e autoriteteve publike dhe publikut, nëpërmjet publikimit të raportit të auditimit.</p>	<p style="text-align: center;">PIESA E KATËRMBËDHIJETË KONTROLLI I LARTË I SHQIPTIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 162</p> <p>1. Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. 2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës. Ai qëndron në detyrë për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.</p> <p style="text-align: center;">Neni 163</p> <p>Kontrolli i Lartë i Shtetit kontrollon:</p> <p>a) veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë; b) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor; c) veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantojnë nga shteti.</p> <p style="text-align: center;">Neni 164</p> <p>1. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit:</p> <p>a) raport për zbatimin e buxhetit të shtetit; b) mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi; c) informacion për rezultatet e kontrolleve sa herë që kërkohet nga Kuvendi. 2. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor të veprimtarisë së tij.</p> <p style="text-align: center;">Neni 165</p> <p>1. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të ftohet të marrë pjesë dhe të</p>
---	---

2.4 Hartimi i raporteve të auditimit, të kuptueshme, të qarta dhe relevante për lexuesin

Me qëllim që raportet e auditimit të gjenerojnë impaktin e duhur dhe të përcjellin në mënyrë të qartë rezultatet e auditimeve të kryera, gjuha e përdorur në to duhet të reflektojë në shkallën maksimale profesionalizmin e institucionit të kombinuar me qartësinë gjuhësore. Duke qenë se raportet e auditimit të KLSH kanë përdorues të shumtë të cilët jo domosdoshmërisht kanë njohuritë e duhura për të përthithur dhe vënë në përdorim gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këto raporte, lind nevoja që në to, audituesi të shprehet mbi gjetjet e auditimit në një mënyrë të qartë, bazuar në fakte të aksesueshme dhe të kuptueshme për këdo që dëshiron të informohet me punën e ekzekutivit, destinacionin dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike në përfitim të qytetarëve taksapagues.

1 Hartimi i udhëzuesit mbi shkrimin e raporteve


KLSH, gjatë vitit 2023, ka hartuar "Udhëzuesin mbi shkrimin e raporteve të auditimit", miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 144, datë 01.08.2023. Ky udhëzues synon të orientojë audituesit drejt rregullave që duhet të mbajnë në konsideratë përgjatë shkrimit të raporteve të auditimit, që të shkruajnë me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, në mënyrë që të gjenerohen raporte të qarta, të vlefshme dhe të dobishme. Në lidhje me këtë udhëzues, janë zhvilluar 5 (pesë) trajnime mbi shkrimin e raporteve të auditimit në mënyrë që të informohet gjithë stafi i KLSH. Në trajnime ka marrë pjesë në rolin e trajnuesit gjithashtu edhe eksperti i jashtëm i cili mbulon njëkohësisht funksionin e redaktimit.



2

Përdorimi i aplikacioneve me qëllim aplikimin e infografikëve

Gjatë vitit 2023, nga ana e Departamentit të Metodologjisë, janë përdorur programe të dedikuara që lejojnë krijimin e infografikëve dhe vizualizimeve, nëpërmjet të cilave janë prodhuar dokumente cilësore dhe profesionale si: Udhëzuesi mbi shkrimin e raporteve të auditimit; Metodologjia e planifikimit vjetor të auditimeve; Buletinet statistikore; Raporti mbi zbatimin e rekomandimeve, etj. Këto programe do të vijojnë të përdoren edhe për implementimin e infografikëve edhe në dokumenta të rëndësishëm si Raporti i Performancës së KLSH-së, Raporti Vjetor i Implementimit të Strategjisë 2023-2027, si dhe në raste të veçanta sipas nevojës.



3

Rikonceptimi i buletinit statistikor

Buletini statistikor është një raport i rëndësishëm i cili përmbledh veprimtarinë e KLSH-së në baza 4-mujore dhe i dërgohet Kuvendit të Shqipërisë si dhe publikohet në faqen zyrtare të KLSH-së me qëllim informimin e palëve të interesit dhe rritjen e transparencës. Për këtë qëllim, KLSH, gjatë vitit 2023 ka ndryshuar formatin e paraqitjes së informacionit në buletinin statistikor, duke e përmirësuar në përmbajtje, duke e pasuruar me infografikë dhe vizualizime si dhe duke përmirësuar mënyrën e të shkruarit me qëllim që të jetë më i qartë dhe më i lehtë për tu lexuar.



2.5


Përdorimi i teknikave të shkruarit profesional që përcjell informacion, gjetje dhe rekomandime në mënyrë të qartë, koncize dhe efektive

1

Përqindja e rekomandimeve të pranuar dhe të zbatuara

Gjatë vitit 2023, u verifikua statusi i 4631 rekomandimeve të lëna në 141 auditime, gjatë vitit të mëparshëm, ku rezultoi se: janë pranuar 4494 masa, ose 97%, dhe nuk janë pranuar 137 masa, ose 3%.

Nga 4494 masat e pranuar, 1753 masa rezultuan të jenë zbatuar plotësisht (ose rreth 39% e total masave të pranuar), 471 masa zbatuar pjesërisht (ose rreth 11 % e total masave të pranuar), 1132 në proces zbatimi (ose rreth 25 % e total masave të pranuar) dhe 1138 masa janë ende pa zbatuar (ose rreth 25% e total masave të pranuar). Më të detajuar raportet e zbatimit të rekomandimeve gjenden ne faqen zyrtare të KLSH-së*



Pranueshmëria dhe zbatueshmëria e rekomandimeve sipas Departamenteve

Departamentet	Pranueshmëria			Zbatueshmëria			
	Pa pranuar	Pranuar	Total	Ne proces	Pa zbatuar	Pjesërisht	Plotësisht
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja	7	503	510	250	70	16	167
Departamenti i Auditimit IT	5	150	155	50	48	6	46
Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit	40	409	449	75	95	43	196
Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore	59	402	461	87	48	12	255
Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetqeverisjes Vendore	11	2444	2455	512	778	321	833
Departamenti i Auditimit të Performancës	15	586	601	158	99	73	256
Total	137	4494	4631	1132	1138	471	1753
%	3%	97%	100%	25%	25%	11%	39%

*https://www.klsh.org.al/content_pdf/274

QËLLIMI 3



OPTIMIZIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE ME QËLLIM ZOTËRIMIN E NJOHURIVE INOVATIVE NË PUNËN AUDITUESE

Në zbatim të Strategjisë, KLSH vlerëson në vazhdimësi efektivitetin dhe përshtatshmërinë e burimeve të nevojshme në raport me detyrimet mandatore dhe aspiratat strategjike, duke i bërë ato pjesë të mendësisë dhe praktikës institucionale. Në këtë linjë, ky qëllim synon që krahas zhvillimit të vazhdueshëm profesional, të mundësojë një mjedis pozitiv dhe shpërblyes pune të qëndrueshëm dhe që stimulon rezultat në sfida inovative.

Gjithashtu, KLSH investon në rritjen e mëtejshme të aftësive të audituesve, në përdorimin e teknologjisë dhe analizimit të të dhënave (big data), në mënyrë që të kryejnë auditime më të thelluara me bazë sistemi, të komunikojnë rezultatet në forma më të kuptueshme dhe inovative, si dhe të rrisin aftësitë reaguese në mënyrë efektive ndaj rrethanave që mund të krijohen si pasojë e situatave emergjente, si ato me të cilat u përballëm në vitet e fundit.

Ky qëllim, përmbushet nëpërmjet tre objektivave të mëposhtme:

3.1 Zhvillimi dhe ruajtja e ekspertizës në fusha/çështje specifike të auditimit në sektorin publik, me fokus në rritje drejt qasjes dixhitale dhe menaxhimit të të dhënave

3.2 Krijimi i një ambienti stimulues, sfidues dhe shpërblyes për stafin auditues, për të krijuar një kulturë pozitive të punuari

3.3 Maksimizimi i vlerës së shtuar të punës së KLSH-së nëpërmjet implementimit të planit strategjik, duke synuar në vazhdimësi të qenit e një organizate model

3.1

Zhvillimi dhe ruajtja e ekspertizës në fusha/çështje specifike të auditimit në sektorin publik, me fokus në rritje drejt qasjes dixhitale dhe menaxhimit të të dhënave

1

Trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve


Nëpërmjet programit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, KLSH ka bërë të mundur rritjen e njohurive dhe aftësive që ju nevojiten audituesve në realizimin e objektivave, për rrjedhojë përmirësimin ndjeshëm të cilësisë së punës audituese në funksion të rritjes së transparencës, mirëqeverisjes dhe përdorimit të parasë publike, si dhe rritjes së besimit të publikut dhe palëve të jashtme, tek KLSH.

KLSH ka kryer në mënyrë periodike analizën e nevojave për trajnim (diktuar këto të fundit nga gjithë stafi auditues nëpërmjet pyetësorëve në google form, të cilët dërgohen në fund të vitit), duke zhvilluar trajnime të brendshme si dhe duke ndjekur zhvillimin e trajnimeve nga aktorë të tjerë, me qëllim përmirësimin e njohurive dhe aftësive të stafit të KLSH-së.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2023, u realizuan gjithsej 207 tema trajnimesh, nga të cilat 99 nga ASPA dhe 108 nga KLSH & partnerë ndërkombëtarë si EUROSAI, IDI, ECA, GAO, SAI i Norvegjisë, ANAC, OECD, etj.

Ndër temat kryesore të realizuara përmendim: tema që prekin çështjet mjedisore, tema mbi auditimet e burimit të sistemeve, forcimi i kapaciteteve audituese për auditimin e koncesioneve/PPP-ve, siguria e informacionit dhe krimi kibernetik, të shkruarit e raporteve, menaxhimi i cilësisë së auditimit, çështje që lidhen me disiplinën buxhetore, metodologji mbi auditimin e bashkive, risku i korrupsionit në fushën e prokurimit publik, çështje që lidhen me auditimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, apo me auditimin e prokurimeve publike etj.

U trajnuan gjithsej 196 auditues, duke realizuar në total 4,854 ditë-njerëz trajnime, nga të cilat 4,465 ditë për 168 staf auditues dhe 389 për 28 staf jo-auditues; ose realizuar mesatarisht rreth 27 ditë trajnimi/auditues (nga 20-25 ditë trajnimi që është objektivi vjetor), dhe 14 ditë trajnimi për staf jo-auditues.



2

Bashkëpunimi me ECA/GAO dhe homologë për forcim kapacitetesh

KLSH ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet homologe me qëllim shkëmbimin e njohurive, pasi “eksperienca e përbashkët na shërben të gjithëve”. Referuar Deklaratës së Rios 2022, nxitja e një zëri global më efektiv dhe reagimi ndaj ndryshimit të mjedisit dhe risqeve, kërkon që SAI-t të përmirësojnë mënyrën se si punojnë së bashku dhe të angazhohen me palët e interesuara.

Gjatë vitit 2023 audituesit kanë marrë pjesë vazhdimisht, në aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare për forcimin e kapaciteteve audituese. Kështu, dy auditues kanë përfunduar me sukses programet e internship-t në Gjykatën Evropiane të Llogarive (ECA) dhe një auditues ka ndjekur programet e fellowship-it pranë Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA (GAO), si dhe të tjerë tashmë zotërojnë certifikata ndërkombëtare profesionale. Të tre audituesit që kanë ndjekur programet në ECA dhe GAO pasi janë kthyer në KLSH kanë zhvilluar trajnime me qëllim ndarjen e eksperiencës me kolegët.



3.2 Krijimi i një ambienti stimules, sfidues dhe shpërblyes për stafin auditues, për të krijuar një kulturë pozitive të punuari

KLSH, si institucion model i cili udhëheq përmes shembullit, ka fokus të vazhdueshëm zhvillimin e punonjësve, krijimin e një mjedisi stimules, sfidues e shpërblyes për stafin, me qëllim krijimin e një kulture pozitive të punuari.

Gjatë vitit 2023, është përditësuar "Dokumenti i Politikave të Burimeve Njerëzore", ku implementimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i tij, do t'i sigurojë stafit të ketë një plan zhvillimi personal që mbështet prioritetet strategjike të KLSH-së dhe njëkohësisht ambiciet personale.



Me qëllim motivimin dhe shpërblimin e punonjësve, gjatë vitit 2023 në KLSH:

- audituesit kanë ndjekur trajnime brenda dhe jashtë vendit duke zhvilluar njohuritë e tyre në fusha specifike të auditimit të jashtëm publik, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
- audituesit janë promovuar nëpërmjet ngritjes në detyrë
- nëpërmjet rotacionit në punë, auditues të ndryshëm kanë përfituar njohuri dhe ekspertizë në fusha të ndryshme auditimi, e cila njëkohësisht u ka shërbyer për nxitje dhe zhvillim profesional dhe personal në këndvështrimin e marrëdhënieve njerëzore gjithashtu.

3.3 Maksimizimi i vlerës së shtuar të punës së KLSH-së nëpërmjet implementimit të planit strategjik, duke synuar në vazhdimësi të qenit e një organizate model

Duke qenë se Strategjia e Zhvillimit 2023 - 2027 udhëheq Kontrollin e Lartë të Shtetit në aktivitetin e tij institucional në një periudhë pesë vjeçare, është me shumë rëndësi që të monitorohet në vijimësi dhe në mënyrë sistematike për vlerësimin e nivelit të arritjes së objektivave kundrejt parashikimit.

Kështu, plani i veprimit për implementimin e strategjisë, është monitoruar periodikisht nga Departamenti i Metodologjisë, në bashkëpunim me të gjithë departamentet/drejtoritë e tjera, me qëllim vlerësimin e punës së bërë nga KLSH për arritjen e objektivave, identifikimin e problematikave, dhe masat e marra për minimizimin e tyre.



OBJEKTIVAT E PAREALIZUARA DHE NË PROCES

1 Objektiva të parealizuar

Referuar Planit strategjik të KLSH, 2023-2027, ku 3 qëllimet strategjike janë detajuar në 11 objektiva, 30 nën-objektiva dhe këto të fundit në 60 tregues performance, rezultoi se:

- nga 58 tregues performance të cilat duhet të realizoheshin gjatë vitit 2023 (pasi 2 tregues kanë objektiv realizimi vitin 2024), u realizuan 55 prej tyre (së bashku me ato që janë në proces dhe priten të finalizohen së shpejti), ose 95%; dhe
- nuk u realizuan 3 tregues ose 5% e tyre.

Treguesit e parealizuar janë:

1. Rritja e pranisë në media sociale për të rritur më tej aksesueshmërinë e palëve të interesuara"
2. Krijimi i një hapësire të dedikuar për anketime (të dy këta tregues janë pjesë e nënobjektivit 2.1.4 "Pasurimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare të KLSH-së, edhe në gjuhën angleze; si dhe krijimi i një hapësire të dedikuar në web për ankesat/kërkesat e publikut, me qëllim rritjen e aksesueshmërisë për të gjitha palët e interesit". Ky nën-objektiv përbëhet nga 6 tregues, ku 4 janë realizuar.
3. Përcaktimi i indikatorit/ëve për vlerësimin e rekomandimeve" që është tregues i nën-objektivit 2.5.1 "Hartimi i rekomandimeve të qarta, të realizueshme dhe të matshme, duke u fokusuar në rekomandime që trajtojnë shkakun dhe jo pasojën.

Për këta tregues do të vijojë puna me qëllim realizimin e tyre gjatë vitit 2024.

2 Në proces realizimi

Nga 55 tregues të realizuar, 3 prej tyre janë akoma në proces zbatimi dhe për to ka nisur puna dhe priten të realizohen brenda vitit 2024.

Treguesit "në proces realizimi" janë:

1. Rishikimi i formatit të Raportit të Auditimit në përputhje me "Udhëzuesin mbi Shkrimin e Raporteve" dhe praktikave më të mira";
2. Standartizimi i dokumenteve bazë dhe metodave inovative për përpunimin e tyre. Të dy këta tregues janë pjesë të nën-objektivit 2.4.2 "Angazhimi i vazhdueshëm i audituesve në trajnime mbi metodat e shkrimit të raporteve të kuptueshme e që i komunikojnë gjetjet në mënyrë të qartë, të saktë e profesionale tek lexuesi". Këta tregues janë në proces realizimi dhe pritet të përmbushen brenda muajit mars 2024, pasi përmbushja e tyre kushtëzohej nga miratimi i rregullores së procedurave të auditimit, e cila u miratua me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 07, datë 17.01.2024.
3. Treguesi i tretë është "Ringritja e grupit për hartimin e propozimeve për ndryshime në ligjin për KLSH nr. 154/2014, duke përfshirë ekspertë të fushës si dhe ekspertizë të organizatave si SIGMA, IDI, SAI i Norvegjise, etj partnerë ndërkombëtarë", i cili është pjesë e treguesit 2.3.2 "Paraqitja e propozimeve për ndryshime në Ligjin për KLSH nr.154/2014, në funksion të kontributit në forcimin e mëtejshëm të efektivitetit të SAI-t", për të cilin po vijon punën grupi i punës i ngritur për këtë qëllim.

ANEKSE

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE/TREGUESVE	NR TREGUESISH
NË PROCES	3
Qëllimi 2 :Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve	3
Ringritja e grupit për hartimin e propozimeve për ndryshime në ligjin për KLSH nr. 154/2014, duke përfshirë ekspertizë të fushës si dhe ekspertizë të organizatave si SIGMA, IDI, SAI i Norvegjise, etj partnerë ndërkombëtarë.	1
Rishikimi i formatit të Raportit të Auditimit ne perputhje me Udhëzuesin e "Te shkruarit te Raportit" dhe praktikave me te mira	1
Standartizimi i dokumenteve bazë dhe metodave inovative për përpunimin e tyre	1
PA REALIZUAR	3
Qëllimi 2 :Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve	3
Analizë nga Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë & Zbatimit të Standardeve me qëllim krijimin e disa indikatorëve për të vlerësuar rekomandimet	1
Krijimi i një hapësire të dedikuar për anketime	1
Rritja e pranisë në media sociale për të rritur më tej aksesueshmërinë e palëve të interesuara	1
PËR TU REALIZUAR NË 2024	2
Qëllimi 1: Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve	2
Përgatitja e Udhëzuesit për Zbatimin e Buxhetit	1
Pilotimi i Udhëzuesit për Zbatimin e Buxhetit	1
REALIZUAR	52
Qëllimi 1: Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve	19
- Aktiviteteve të përbashkëta me SAI-et homologe dhe INTOSAI, për çështje që lidhen me: -auditimet në fushën e mjedisit -auditime mbi barazinë gjinore -IT tools -zhvillimin e metodologjive për auditime në kohë reale	1
Auditimet që përzgjidhen bazuar në Udhëzuesin e Riskut (në nr ose %)	1
Numri i aktiviteteve të përbashkëta me Kuvendin, me qëllim rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve	1
Analiza e rezultateve nëpërmjet kryerjes së analizave vjetore	1
Azhornim i manualeve dhe udhëzuesve në koherencë me ndryshimet e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të rishikuara	1
Dizenjimi i aplikacioneve në funksion të menaxhimit të proceseve dhe te dhenave, në mënyrë të automatizuar	1
Fushat e reja sipas OZHQ-ve	1
Hartimi i planit vjetor të auditimeve mbështetur në zhvillimet makro-ekonomike në financat publike (fushat me risk)	1
Monitorim i vazhdueshëm me qëllim ndryshimin e planit për të reflektuar dinamikat makroekonomike dhe prioritetet, në planin e auditimeve, sipas nevojës.	1
Nr i auditimeve që mbulojnë fushat e rekomanduara nga Axhenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 (OZHQ)	1

REALIZUAR	52
Qëllimi 1: Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve	19
Nr i fushave të audituara në bazë sistemi	1
Numri i dëgjesave të zhvilluara në Kuvend dhe në Komisionin e Ekonomisë dhe komisione të tjera parlamentare, për çështjet me interes të veçantë të trajtuara në auditime	1
Numri i raporteve të auditimit të përcjella në Kuvend	1
Numri i raporteve të auditimit të përcjella në Ministrinë e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin	1
Periodiciteti i rishikimit të Udhëzuesit të Fushave me Risk, dhe shndërrimi i tij në Metodologji në përfundim të periudhës 5 vjeçare	1
Plotësimi dhe përditësimi periodik i Platformës Ndërinstitucionale Online të Kuvendit mbi zbatimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara	1
Riorganizimi i statistikave në funksion edhe të zbatimit të rekomandimeve si dhe hartimi i një moduli të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, në Sistemin e Menaxhimit të Auditimeve.	1
Zhvillimi i moduleve të IT, nëpërmjet zhvillimit të strukturës IT si dhe në kuadër të marrëdhënieve ekzistuese të bashkepunimit me SAI-e homologe, në këtë drejtim	1
Zhvillimi i trajnimeve dhe përgatitja e informacionit nëpërmjet doracakeve/udhëzuesve/broshurave, etj.	1
Qëllimi 2 :Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve	23
Numri i kronikave që jepen në median vizive lidhur me raportet e auditimit.	1
Përqindja e rekomandimeve të zbatuara nga subjektet e audituara, në nivel auditimi / audituesi / departamenti	1
Hartimi i Udhëzuesit për "Të shkruarin e Raporteve"	1
Investime në aplikacione të përdorshme nga audituesit me qëllim aplikimin e infografikëve edhe në raporte auditimi	1
Klikimet e faqes zyrtare të KLSH-së	1
Komunikimi për shtyp i rezultateve 4 mujore	1
Ngritja e një njësie të dedikuar për redaktimin e raporteve (ose punonjës i dedikuar për redaktimin) dhe dokumentave të auditimit	1
Nr i broshurave të përgatitura mbi rezultatet e auditimeve me ndjeshmëri të lartë	1
Nr i ekspertëve të jashtëm të angazhuar në auditime, me ekspertizë në fusha të vecanta si në atë të hidrokarbureve, OZHQ-ve, teknologjinë e informacionit, etj.	1

Qëllimi 2 :Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve	23
Nr. i auditimeve për të cilat është bashkëpunuar me SPAK dhe organe te tjera	1
Numri i aktiviteteve të bashkëpunimit dhe tryezave të rrumbullakëta me organet e linjës së parë në luftën kundër korrupsionit.	1
Numri i artikujve dhe kronikave që publikohen në median e shkruar ose jepen ne median audiovizive lidhur me rezultatet e auditimeve te KLSH	1
Numri i raporteve të auditimit që i dërgohen aktorëve kryesorë	1
Numri i trajnimeve të kryera mbi metodat e shkrimit të raporteve	1
Numri total i ankesave dhe kërkesave për informacion	1
Organizimi i aktiviteteve të ndryshme, me perfaqësues të shoqërisë civile	1
Pasurimi i faqes zyrtare me opsionin e gjuhës angleze	1
Përgatitja e broshurave "Fakte & figura" për web	1
Përqindja e rekomandimeve të pranuar nga subjektet e audituara , në nivel auditimi / audituesi / departamenti	1
Promovimi i faqes web nëpërmjet statistikave që shndërrohen në lajm	1
Rikonceptimi i Buletinit Statistikor	1
Shoqërimi i raporteve te auditimit të performancës me broshura mbi rezultatet e auditimit	1
Vijimi i raportimit në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Antikorrupsion	1
Qëllimi 3: Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese	10
Data Base për vlerësimin e performancës & hartimi i planeve personale;	1
Data bazë me informacione për zhvillimet profesionale dhe akademike të çdo audituesi.	1
Ngritja e grupeve të punës për ndjekjen e Strategjisë Hartimi i planit të monitorimit të Strategjisë	1
Niveli i qarkullimit brenda institucionit;	1
Numri i audituesve që kryejnë internship në ECA, GAO apo institucione të tjera me SAI-e homologe	1
Numri i audituesve të ngritur në detyrë;	1
Numri i audituesve të rekrutuar sipas fushës kundrejt numrit total të audituesve;	1
Numri i ditëve të trajnimit për çdo auditues	1
Numri i temave të auditimit të propozuara nga audituesit e trajnuar jashtë, të cilët sjellin praktika të mira	1
Përqindja e audituesve të trajnuar jashtë, që bëjnë trajnime për kolegët për të ndarë njohuritë e marra	1
Grand Total	60



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Të dhënat mbi realizimin e objektivave të strategjisë, janë raportuar nga departamentet e auditimit dhe strukturat e tjera përgjegjëse për realizimin e objektivave, dhe janë mbledhur dhe përpunuar nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional.

Raporti i monitorimit është përgatitur nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional

Ky raport përfshin linqe ndërvepruese që mbështesin përmbajtjen. Për të aksesuar këtë funksion, ju lutemi shikoni versionin dixhital të këtij raporti në www.klsh.org.al.



Rruga "Abdi
Toptani" Nr.1 Tiranë



klsh.org.al



+355 4 2247294



klsh@klsh.org.al